



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Raporti mujor i punës për muajin Shtator, viti 2025

Tetor, 2025



Drejtori: Ali Arifi

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – DUPMM për periudhën 01 Shtator 2025 – 30 Shtator 2025.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM), në përputhje me kompetencat ligjore, planin vjetor të punës për vitin 2025, si dhe objektivat e përcaktuara në këtë plan, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës për muajin Shtator 2025.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe rezultatet e të gjithë sektorëve të DUPMM-së duke u fokusuar në fushat e planifikuara, të cilat përbëjnë objektivat e punës së drejtorisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2025.

Raporti bazohet në të dhënat periodike të sektorëve të DUPMM-së dhe komisioneve, përkatësisht:

- Sektorit për Punë të Përgjithshme Juridike,
- Sektorit të Urbanizmit,
- Sektorit të Planifikimit,
- Komisioneve për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së I-rë dhe të II-të,
- Komisionit për leje mjedisore.

Gjatë periudhës kohore, 01 Shtator 2025 – 30 Shtator 2025, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka pranuar për shqyrtim **87 lëndë**.

Nga numeri i përgjithshëm i kërkesave të pranuara, numeri i lëndëve të shqyrtuara apo që kanë marrë përgjigje është 49, ndërsa në proces të shqyrtimit apo lëndë të cilat ende nuk kanë marrur ndonjë përgjigje nga organi shqyrtues janë 38 lëndë.

Në proces të shqyrtimit janë = 122 lëndë (Sektori për Punë Juridike dhe të Përgjithshme = 7, Sektori i Planifikimit = 11, Sektori i Urbanizmit = 13, Komisioni i Legalizimit kat.I-rë=68, Komisioni i Legalizimit kat. II-të =15, Komisioni për verifikimin e dokumentacionit për pranim teknik, = 8), **gjithsej: 122 lëndë**.

Statusi i lëndëve të pranuara për shqyrtim nga Qendra për Shërbim me Qytetar dhe Arkivim

Nr.	Klasifikimi i lëndëve	
1	Lëndë të kompletuara	78
2	Lëndë të pa kompletuara	9
Gjithsej		87

Lloji i akteve të përpunuara:

Nr.	Emërtimi i aktit	
1	Vendime për lejimin e ndërtimit – Kategoria I-rë	3
2	Vendime për lejimin e ndërtimit – Kategoria II-të	3
3	Vendime për kushte ndërtimore - Kategoria I-rë	3
4	Vendime për kushte ndërtimore - Kategoria II-të	2
5	Vendime për përfundimin e procedimit administrativ	1
6	Vendime për korrigjimin e akteve administrative	4
7	Vendime për leje rrërimi	1
8	Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit	52
9	Vendime për përfshirje në listë të pritjes	11
10	Vendime për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale	3
11	Vendime refuzimi	3
12	Pëlqime për ndarjen e njësisve banesore dhe lokaleve afariste	1
13	Pëlqime urbanistike për parcelim	9
14	Ekstrakte	13
15	Njoftime, lidhur me prezantimin e dokumentacionit	9
16	Përgjigje në kërkesë	3
17	Konfirmime mbi pranimin e shkresave dhe akteve	3
18	Dërgim i lëndës për shkak të jo kompetencës, organit kompetent	1
19	Dërgim i ankesës me shkresa përcjellëse në MMPH	1
20	Kërkesa për pagesë shtesë	2
21	Informata	5
22	Njoftime	3
Gjithsej		136

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrotjtje të Mjedisit për muajin Shtator 2025

Nr.	Përshkrimi	Realizimi Shtator 2024	Planifikimi 2025	Realizimi Shtator 2025	% e realizimit në Shtator të vitit 2025 në raport me muajin Shtator 2024	% e realizimit në Shtator të vitit 2025 në raport me planifikimin për vitin 2025
A	TË HYRAT					
1	Të Hyrat nga Lejet Ndërtimore	116,468.72	757,000.00	78,139.54	67 %	10 %
2	Të Hyrat nga Taksat – Kërkesat	190.00	2,000.00	-	-	-
3	Legalizimet	1,974.42	31,000.00	4,005.87	203 %	12.9 %
4	Të Hyrat nga Lejet Mjedisore	14,239.00	65,000.00	9,056.00	64 %	14 %
5	Të Hyrat nga Rrënimet e objekteve	1,186.52	5,000.00	-	-	-
	Gjithsej	134,058.66	860,000.00	91,201.41	68 %	11 %
B	SHPENZIMET					
1	Mallra dhe Shërbime	6,201.81	380,000.00	80.00	1%	-
2	Komunalitë	157.43	9,000.00	1,564.27	994 %	17.4 %
3	Investimet kapitale	-	230,000.00	-	-	-
	Gjithsej	6,359.24	619,000.00	1,644.27	26 %	0.3 %